



## THE KENNEDY-LUGAR YOUTH EXCHANGE AND STUDY

### Mësoni më shumë për këtë program të ri shkëmbimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

**YES – Youth Exchange and Study** është një program pa pagesë që siguron bursa studimi për nxënësit e shkollave të mesme nga vendet YES për të kaluar deri në një vit akademik (2013-2014) në Shtetet e Bashkuara, duke jetuar me familje amerikane dhe duke ndjekur një shkollë të mesme amerikane.

Fokusi i programit është zhvillimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve nga Shtetet e Bashkuara dhe vendeve partnere, me qëllim ngritjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Nxënësit jetojnë në një familje pritëse, ndjekin një shkollë të mesme, angazhohen në aktivitete për të mësuar mbi shoqërinë dhe vlerat amerikane, sigurojnë aftësi drejtimi dhe ndihmojnë në edukimin e amerikanëve mbi vendin dhe kulturën e tyre.

### Ky program mbështetet financiarisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit

Faza e parë e konkurimit:	Data	Adresa
Qyteti	ora 8:30 to 11:00	
Tiranë	1 Tetor	Universiteti "Marin Barleti", Rr. "Sami Frashëri", nr. 41 (pranë kompleksit të pishinave)
Fier	3 Tetor	Universiteti Kristal Ish-Turizmi

**Të gjithë nxënësit duhet të regjistrohen personalisht ditën e testimit; nxënësit nuk mund të regjistrohen online, me anë të e-mail-it ose në telefon.** Testi i parë do të bëhet në të njëjtën ditë dhe orë që do të përcaktohet në momentin e regjistrimit. Për të gjithë ata që kualifikohen, testi i dytë do të bëhet të nesërmen. Një listë me pjesëmarrësit e raundit të dytë do të bëhet publike në mbrëmjen e ditës së parë të testimit.

### Kushtet e pranimit si Aplikant: Aplikanti duhet të plotësojë këto kushte:

- Datëlindja nga 1 janar 1996 – 15 korrik 1998
- Nxënës në shkollë të mesme, klasa 10 ose klasa 11
- Nxënës me rezultate të mira
- Njohuri të mira të gjuhës angleze
- Të jetë shtetas shqiptar
- Nxënësit me aftësi të kufizuar duhet të kenë lindur nga: 15 Mars 1995-15 korrik 1998.
- Per moshën dhe klasën e nxënësve me aftësi të veçanta, kontaktoni zyrën tonë.

### Dokumentet që duhet të paraqiten:

#### Aplikanti duhet të paraqesë:

- Fotografi të kohëve të fundit 3 x 4 cm;
- Pasaportë, Certifikatë lindjeje; ose kartë identiteti
- një stilolaps

### Për informacione më të hollësishme kontaktoni:

American Councils for International Education  
(brenda Dhomës Amerikane të Tregtisë)  
Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Sky Tower, 11-3, Tiranë  
+355 4 2 235 347  
[tirana@americancouncilssee.org](mailto:tirana@americancouncilssee.org), [www.ac-see.org](http://www.ac-see.org)